# DËSHMI ARKIVI

**A-411752**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Takimi me shqiptarët në SHBA/ Berisha mbërrin në sallë, diaspora pret me brohoritje kreun e PD |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/o-sali-o-hero-gjithe-shqiperia-ty-te-do-diaspora-e-mahnitur-nga-kreu-i--i102723` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 16:32:07 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| KOHA E PORTALIT | nuk jepet<br>*Ky portal nuk e deklaron datën dhe nuk e shkruan as të dukshme. Mbetet vetëm ora jonë e kapjes.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `10ffb994f1964538b8452b064b70338b4394064921662c2e5368ea4eca1ec8dc` |
| TEKSTI | `be8315f3dc4a7e69324fcb91f285d5c644f43d407acb92eb11bd763dd50a6632` |
| PAMJA | `ffd7708ad0b9d9b6a52b0e7abb5dbbbc3a8af52c8dbf38d3bf9f7d9f90c3206d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `eeb419ed2c050e1c4b308de8afc2426aa1974c1a6954e1803c2b19d21e9b8236` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/eeb419ed2c050e1c4b308de8afc2426aa1974c1a6954e1803c2b19d21e9b8236`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Takimi me shqiptarët në SHBA/ Berisha mbërrin në sallë, diaspora pret me brohoritje kreun e PD

Piranjat Përditësimi i fundit 6 Shtator 2026, 17:59

Takimi me shqiptarët në SHBA/ Berisha mbërrin në sallë.

"O Sali o hero, gjithë Shqipëria ty të do", kështu e kanë pritur shqiptarët e Amerikës ish-kryeministrin Sali Berisha, në një takim me diasporën shqiptare në një nga sallat në New Jersey.

Të entuziazmuar, shqiptarët e Amerikës e kanë pritur me duartrokitje dhe kanë kërkuar të shtrëngojnë duart me Berishën, i cili gjatë fjalës së tij u kthye pas në kohë, duke kujtuar vizitën e tij të parë në Shtetet e Bashkuara, në mars të vitit 1991.

Berisha e cilësoi atë vizitë si një nga udhëtimet më emocionuese të jetës së tij, ndërsa vlerësoi rolin e diasporës shqiptare në SHBA në përmbysjen e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe në mbështetjen e Kosovës.

Duke folur për takimin e fundit me shqiptarët e Amerikës, ai e cilësoi edhe këtë vizitë si historike dhe emocionuese, pasi sipas tij shumëkush e kishte menduar si të pamundur. Berisha u ndal te sfidat dhe vështirësitë e viteve të fundit, ku ai u shpall non-grata në Amerikë, duke theksuar se përgjigjja ndaj çdo dyshimi për forcën për të përballuar padrejtësitë mbetet e njëjtë, identiteti shqiptar.

Ndërkohë që pati dhe një mesazh për të gjithë ata që luftuan për ta shpallur non-grata, duke u thënë se sot ata janë "prapa hekurave", ndërkohë që vetë ai ndodhet aty, në tokën amerikane.

"Të dashur vëllezër, miq, zonja dhe zotërinj shqiptaro-amerikanë. Përshëndetjet e mia më të përzemërta, mirënjohjen më të pakufishme për këtë pritje vëllazërore. Kënaqësinë më të madhe që unë takohem sot me ju, me të njëjtin besim që kam pasur në mars të vitit '91, në udhëtimin tim të parë në këtë vend të bekuar. Ai ishte një udhëtim më emocionali në jetën time, emocionet vërshonin nga kënaqësia se unë po udhëtoja në drejtimin e duhur pas dekadash që vendi im kishte humbur drejtimin. Kënaqësia ime e jashtëzakonshme ishte se po takoja ju, zëri i pamposhtur i shqiptarëve në liri. Pata fat të madh se takova atë diasporë shqiptare, e cila me atdhetarinë e saj, me idealet demokratike, me idealet kombëtare, dha një kontribut të jashtëzakonshëm në përmbysjen e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe luftoi me të gjitha mjetet për lirinë e Kosovës.

Diaspora shqiptare në SHBA është fati i bardhë, i fati i mirë i kombit shqiptar. Për ne sot kjo është një ditë jo e zakonshme, sot është një ditë që për mua përsëri ngjall emocione. Është një ditë që shumëkush e ka menduar të pamundur, e ka menduar si një ditë që nuk do ta shihnim ndonjëherë, sepse le të jem i sinqertë, shumë prej nesh të paktën njëherë ose më shumë kemi pyetur veten: kush jemi ne, kush jemi ne për të sfiduar një padrejtësi, kur ajo padrejtësi bëhet nga forca shumëfish më të mëdha se ne.

Jo pak herë kemi pyetur veten këto vite, kush jemi ne që zëri ynë i së drejtës të dëgjohet në një botë kur, për fat të keq, gjithmonë dhe më shumë sundohet nga e padrejta, kush jemi ne që të qëndrojmë të fortë kur në momente të caktuara e gjithë bota dukej kundër nesh, këto janë pyetje që të bëjnë të ndihesh i vogël në një botë të madhe, i pafuqishëm përballë padrejtësive, por kjo pyetje "kush jemi" e ka një përgjigje që përjetësisht do të jetë burim i pashtershëm i fuqisë sonë për të bërë të pamundurën të mundur, ne jemi shqiptarë! Sepse ne jemi shqiptarë dhe qëndrojmë dhe luftojmë të pamposhtur për dinjitetin tonë, sepse ne jemi shqiptarë, luftojmë dhe qëndrojmë të vendosur për familjen tonë, ne jemi shqiptarë ndaj dhe luftojmë në kushte më të pabarabarta për kombin tonë, dinjitetin dhe lirinë e tij.

Ne jemi shqiptarë ndaj dhe nuk dorëzohemi, prandaj ditë si kjo të pamundura ne i bëjmë të mundura. Zoti ju bekoftë", tha Berisha.

## Artikuj te sugjeruar


POLITIKE 6 Shtator17:38

**[Pritje madhështore, shqiptarët e SHBA brohorasin për vizitën e Berishës: Rama në burg]**

Shqiptarët e SHBA i kanë rezervuar një pritje madhështore Kryetarit të PD-së Sali Berisha në nisje të takimit me diasp...

POLITIKE 6 Shtator17:17

**[Këlliçi nga New Jersey: Takimi më madhështor i organizuar ndonjëherë nga një politikan shqiptar në SHBA]**

Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi, ka përcjellë një videomesazh nga New Jersey, në prag të takimit të Kryetarit t&...

Nga Petrit Vasili POLITIKE 6 Shtator15:53

**[Kapitalizmi çnjerëzor i Ramës dhe ai i human i Greqisë!]**

Rama tregohet haptas çnjerëzor dhe i pamëshirshëm me qytetarët dhe rrit taksat dhe çmimet, ndërsa Greqia rrit pensionet...

POLITIKE 6 Shtator13:48

**Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikës shndërrohet në leksione gjeopolitike**

Sali Berisha ka gjetur në Nju Jork skenën e radhës për të bërë atë që di më mirë: të ulet në ...

POLITIKE 6 Shtator13:49

**Nuk ka transparencë/ Toni Blair, 100 mijë euro nga kontratat me Edi Ramën**

Instituti i Toni Bler ka përfituar mbi 94 milionë lekë ose 100 mijë euro nga qeveria Rama gjatë vitit 2025, ndërsa kontratat dhe...

POLITIKE 6 Shtator13:41

**"Bashkia nuk ka kokë", Rama: Veliaj ishte talent, 'e hëngri' pushteti**

Edi Rama ka rikthyer në vëmendje krizën e drejtimit të Bashkisë së Tiranës, ndërsa kryebashkiaku Erion Veliaj ndodhet ...

POLITIKE 6 Shtator12:51

**“46% e shqiptarëve janë larguar në 10 vite”/ Berisha në SHBA: Droga ka deformuar ekonominë dhe financat**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e cilësoi shpopullimin, ekonominë dhe ndikimin e krimit të organizuar si problemet kryesore me t...

POLITIKE 6 Shtator12:39

**Levani shkrumb e hi/ Deputeti i PD Shikoni pamjet e zonës, pasi ‘heronjtë’ e partisë me praninë ‘besnike’ shuan zjarrin**

Deputeti i PD, Luan Baçi, ka reaguar për situatën e zjarreve në Levan, duke kundërshtuar deklaratat e autoriteteve për stabili...

POLITIKE 6 Shtator12:20

**Vazhdon tallja me shqiptarët/ “Prania Besnike” nis me bllokun bosh të Sara Milës: I kemi shënuar të gjitha**

Pas premtimeve, fjalimeve dhe “dëgjimit” të halleve të shqiptarëve, Partia Socialiste ka nisur një tjetër tur takimesh...

POLITIKE 6 Shtator11:15

**Zhupa kundër ligjit për zonat e mbrojtura: Një shkrepëse mjafton që zona të kthehet në shesh ndërtimi**

Kryetarja e Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën, Ina Zhupa, ka rikthyer debatin për ligjin 21/2024 për zonat e mbrojtura,...

## ME TE VIZITUARAT

SHOWBIZ 5 Shtator

**Deputetja e Kuvendit pozon para pasqyrës e vesh...**

Deputetja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Adriana Matoshi, ka zgjedhur të ndajë me “ndjekësit” e saj n&eum...

AKTUALITET 6 Shtator

**Çfarë ndodhi mbrëmë në Sarandë? Operacion antid...**

Një opreacion antidrogë është zhvilluar gjatë mbrëmjes së 5 shtatorit në Sarandë. Në kuadër të aks...

Piranjat News AKTUALITET 6 Shtator

**VIDEO/ Parakalim i rrezikshëm në Librazhd, deno...**

Një qytetar ka denoncuar në redaksinë e Piranjat News një rast të rëndë parakalimi të gabuar dhe të rrezikshë...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video

## Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave

**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**

**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**

**Gruaja me dy identitete që premton “shërim” me ujin e kufomave në Pejë**

**A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?**

**Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët**

**Flamur Gjuzi, i dënuar për"shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?**

**Pallatet u zhytën“Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit**

**Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë**

**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15**

**Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)**

**Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës**

**Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.**

**Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje**

**Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.**

**Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.**

**“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet**

**Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti**

**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14**

**Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas**

**Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi**

**Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime**

**Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote**

**Artisti dhe Frika**

**Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe ‘lufta’ për 200 mijë euro!**

**14-vjeçare me dr*gë dhepro*titucion, rrjeti i errët i minoreneve të zhdukura**

**Zhytja e pallateve te Alabarit/ IKMT pranon anomalitë në “Durrës Marina”: Janë zhytur 28 cm**

**"Ederlezi", festa e veçantë e komunitetit rom.**

**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 13**

**Do t’i fus duart edhe nëse bërtet, motra e 13 vjeçares rrëfen tmerrin e mesazheve që mësuesi ia çon**

**“Inspektori gjobëvënës” i bashkisë terrorizon qytetarët**

**Pagat e mohura të druvarëve në Navaricë! Miliona lekë për të marrë dhe kërcënime**

**Rruga Thumanë–Kashar/ 1 miliard euro dhe “5 lekëshi” që po merret nga xhepat e qytetarëve**

**Me viza turistike ose kontrata futbolli drejt Europës/ Kush fshihet pas skemës së trafikimit?**

**Nënat denoncojnë ikjet nga shtëpia dhe jetën e dyshimtë të adoleshentëve**

**Për mediat dhe fëmijët**

**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 12**

**Muzikanti i rruges “vjedh” koleget. Banka e fundit**

**Dajak për 50 metra rrugë në Dibër, kushërinjtë në ’luftë’ për pronën.**

**Fisnik Syla, “BAMIRËS” apo shantazhues**

**A janë "idiotë "shqiptarët e Maqedonisë së Veriut? Çfarë do të thoshte Arbën Xhaferraj?**

**Presidenti i FSHP reagon për deklaratat e Erkand Qerimaj: Lajthita atëherë, tani kam reflektuar**

**Nga jetimorja te humbja e kujdestarisë. Rrëfen nëna që kërkon bashkimin me vajzën pas 13 vitesh**

**Tigrat e Vlorës: energjia që prodhohet 6 herë më shtrenjtë se sa shitet.**

**Skandali i zhytjes së pallateve në Durrës Marina / Ndërhyn IKMT.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.